Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian

Programi Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor/ ReLOaD financohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP)

ETNO LEZHA

HISTORY IN CLOTHING - HISTORIA NË KOSTUME

ALBUM FOTOGRAFIK

PHOTO ALBUM

ISBN 978-9928-07-656-4

Album fotografik	**“ETNO LEZHA”**	Photo Album
Përgjëgjës për realizimin:	Hekuran Koka	Responsible for the realization
Fotografitë:	Olsi Tetaj	Photographer
Konsulente Etnografe:	Tereze Gega	Ethnographer Consultant
projekti	TRADITA SI MUNDËSI PËR TË RINJTË E LEZHËS	project
Drejtor Projekti	Mark Ruçi	Project director
Asistente Projekti	Esmeralda Ndoka	Project assistant
Design:	Hekuran Koka	Layout

PRINTED BY GEER PUBLISHING HOUSE
LEZHË 2019

Puna për hartimin e këtij albumi ka qenë një sfidë e vërtetë, sidomos për sa i takon përzgjedhjes së kostumeve të duhura dhe sidomos për të mos patur artifica të panevojshme. Sidoqoftë, ne e kemi të qartë se diçka edhe mund të na ketë shpëtuar, ndaj do ju luteshim që kushdo që vë re mangësi të na i bëjë me dije.
Dëshirojmë të falëndërojmë të gjithë ata që na kanë qëndruar pranë e që na kanë përkrahur për realizimin e këtij projekti. Stafi i ReLOaD dhe stafi i Bashkisë Lezhë kanë qenë një ndihmesë e jashtëzakonshme.
Gjithashtu duam të falendërojmë Z. Gjovalin Gjeloshi, Patër Pashko Gojçaj nga Famullia e Tuzit, z. Shtjefën Ujkaj, Z. Luigj Dedvukaj e Z.Vinko Prekocaj, nga Tuzi dhe z. Gjovalin Pëllumbaj nga Vermoshi për bashkëpunimin në gjetjen e veshjeve tipike autoktone të Malësisë.
Z. Ndue Dedaj, Z. Gjergj Marku dhe Pallatin e Kulturës Mirditë për ndihmesën në veshjet Mirditore.
Zj. Ema Osmani dhe zj. Dhurata Shiroka për veshjet qytetare dhe Z.Gazmend Golemi për këshillat e vyera.
Një falënderim shumë special shkon për Z. Pashk Smaçi dhe Z. Kurt Lika që na ndihmuan për të gjetur veshjet e Pllanës dhe Kurbinit, atëherë kur u duk e pamundur se këto veshje mund të gjendeshin.
Gjithashtu duam të falendërojmë të gjithë ata që na ndihmuan në realiizimin e fotografive, stafin e Memorialit të Skënderbeut, Mrizin e Zanave, Katedralen e Lezhës për mundësimin e ambjenteve.
Dhe padyshim të gjithë ata që pranuan të modelojnë me veshjet e tyre apo të Artistike Zadrima meritojnë një falendërim të veçantë.
Faleminderit!

ETNO LEZHA

ALBUM FOTOGRAFIK | PHOTO ALBUM

Working on this album has been a real challenge, especially in choosing the right costumes and especially not providing unnecessary artifacts. However, we are aware that something may have escaped our eye, so we would urge anyone who notices deficiencies to let us know.

We would like to thank all those who have stood by us and supported us in carrying out this project. ReLOaD staff and Lezha Municipality staff have been a tremendous help.

We would also like to thank Mr. Gjovalin Gjeloshi, Father Pashko Gojçaj from the Tuzi Parish, Mr. Shtjefën Ujkaj, Mr. Luigj Dedvukaj and Mr. Vinko Prekocaj from Tuz and Mr. Gjovalin Pellumbaj from Vermoshv for cooperation in finding typical traditional Malsia costumes.

Mr. Ndue Dedaj, Mr. Gjergj Marku and the Mirdita Palace of Culture for assisting in Mirdita dresses.

Ms. Ema Osmani and Ms. Dhurata Shiroka for Lezha's town costumes and Mr. Gazmend Golemi for valuable advice.

A very special thank goes to Mr. Pashk Smaçi and Mr. Kurt Lika for helping us find the costumes of the Pllana and Kurbin photo sessions when it seemed unlikely that these costumes could be found.

We also want to thank all those who helped us with the photography, the staff of the Skanderbeg Memorial, Mrizi i Zanave Agritourism, Restorant Antika and the Lezha Cathedral for providing the facilities.

And definitely anyone who modelled for us with their inherited costumes or Artistic Zadrima deserves a special thank you.

Thank you!

Lezha është sot qyteti që bashkon tri treva me rëndësi të veçantë etno-kulturore për Shqipërinë e Veriut, Zadrimën, Mirditën dhe Malësinë e Madhe. Këto krahinat nuk e njohën asnjëherë pushtimin osman, por u vetëqeverisën sipas ligjeve të princit të tyre të fundit, Lekë Dukagjinit dhe jetuan me kujtimin e bëmave të Skënderbeut. Këtyre tre entiteteve etnografike u shtohen edhe tri enklava më të vogla numerikisht, por ndoshta jashtëzakonisht të rëndësishme për studimin e trashëgimisë kulturore të shqiptarëve, Kallmeti, Pllana dhe Shehri. Të trija këto zona ruajnë një identitet të veçantë në etnografinë e tyre, duke u bërë një urë lidhëse dhe plotësuese të arealit të plotë atnografik të zonës. Mjafton të thuhet se sipas disa studiuesve, veshja bardhe e zi e Kallmetit mund të jetë e trashëguar që nga koha e ilirëve dhe e patjetërsuar në këtë zonë përgjatë gjithë historisë.

Në gjithë këtë areal të jashtëzakonshëm të trashëgimisë kulturore mungojnë botimet profesionale për ruajtjen, katalogizimin dhe promovimin e këtyre objekteve. E gjithë kjo shoqëruar me ritmet e shpejta të shëndërrimit të shoqërisë në epokën e internetit dhe globalizmit, e bën nevojë të patjetërsuar ruajtjen e tarshëgimsië kulturore si një trashëgimie papërsëritshme.

Ky projekt do të ndikojë direkt te moshat e reja të gjimnazistëve për njohjen dhe identifikimin me trashëgimë e pasur kulturore të trevës së tyre, do të ndihmojë në impakt afatmesëm në promovimin e trashëgimisë kulturore, dhe unifikimin e punës së artizaneve si dhe do të ndikojë në shtimin e sipërmarrjeve artizanale në zonën e Lezhës që i dedikohen trashëgimisë kulturore, si dhe në nivel afatgjatë do të jetë një kontrbut i jashtëzakonshëm në ruajtjen e kësaj pasurie të papërsëritshme të popullit shqiptar.

Ky album është prodhuar në kuadër të projektit "Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD)", i cili financohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Përmbajtja e këtij publikimi, si dhe gjetjet e paraqitura në të, janë përgjegjësi e Qendrës për Zhvillim dhe Integrim - CDI, dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian (BE) ose Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

TRADITA SI MUNDËSI PËR TË RINJTË E LEZHËS

Lezha is today a city that unites three territories of particular ethno-cultural importance to Northern Albania, Zadrima, Mirdita, and Malsia. These provinces never recognized the Ottoman occupation, but they governed themselves according to the laws of their last prince, Lekë Dukagjini, and lived in remembrance of the deeds of Skanderbeg. To these three ethnographic entities are added three smaller enclaves numerically, but perhaps extremely important for the study of the Albanian cultural heritage, Kallmeti, Pllana and Shehri. All three of these areas maintain a unique identity in their ethnography, becoming a bridge and complementary to the full ethnographic caleidoscope of the area. It would be enough to say that according to some scholars, Kallmet's black-and-white dress may have been inherited from the time of the Illyrians, and has been imminent in this area throughout history.

In all this extraordinary area of cultural heritage, there is a lack of professional publications for the preservation, cataloging and promotion of these objects. All this, coupled with the rapid pace of transforming society in the age of the Internet and globalization, makes it imperative to preserve cultural heritage as an unrepeatable legacy.

This project will directly impact the young ages of high school students in recognizing and identifying the rich cultural heritage of their area, helping in the medium term to promote cultural heritage, and unifying the work of artisans and affecting the addition of artisanal enterprises in the area of Lezha and will of course give a great contribute in the conservation of this unique inheritance of the Albanian culture.

This album was produced in the framework of the project "Regional Program for Local Democracy in the Western Balkans (ReLOaD)", which is funded by the European Union (EU) and implemented by the United Nations Development Program (UNDP). The contents of this publication, as well as the findings presented herein, are the responsibility of the Center for Development and Integration - CDI, and do not necessarily reflect the views of the European Union (EU) or the United Nations Development Program (UNDP).

ZADRIMA

Zadrima, ose siç njihej në antikitet dhe në mesjetën e hershme: Sapa, është një vend-banim i hershëm, siç dëshmojnë tumat ilire në mes të fshatrave Blinisht e Fishtë. Sapa, Zapa apo Capi, është një qytezë e vjetër, gjurmët e të cilit gjenden në rrënojat e Shatit mesjetar, mbi fshatin Nënshat të sotëm. Toponime të ndryshme si Ura e Shkinës, Ura PlakGjon; apo ndërtimet si Kisha e Zojës në Troshan, e Shën Shjefnit në Blinisht, apo e Shën Mërisë mbi Vaun e Dejës, janë kryesisht të shekullit të XIII. Qytete të mirënjohura të Zadrimës antike e mesjetare ishin Shurdhahu, Zhavorina, Danja, Sapa etj.

Dasma zadrimore, është një tjetër dëshmi e gjallë një kulture shumëshekullore, elementë të së cilës përbëjnë edhe bazën e dasmës së vjetër shkodrane. Fshatrat e Zadrimës, janë të mbushura me kulla mbi 150-vjeçare, ku bie në sy kutura arkitektonike dhe ajo e përpunimit të hekurit e të drurit, po ashtu edhe si dëshmi e mënyrës së jetesës të familjeve të mëdha zadrimore. Tradita e punimit të rrobave zadrimore në vekë (manifakturë) ruhet edhe sot e kësaj dite, ashtu siç edhe ajo e poçerisë. Kultivimi i hardhisë, ullirit, shegës, fikut, ftonit dhe frutave të tjera; krahas bimëve të lashta si gruri e misri, apo mbarështrimi i blegtorisë; janë disa ndër gjërat për të cilën shquhen zadrimorët.

Gjergj Fishta, është më I madhi I një serie emrash të mëdhënj që ka nxjerrë kjo trevë, e cila fatkeqësisht sot nuk ka shumë investime që e përjetësojnë këtë trashëgimi, si muze apo shtëpi përkujtuese. Në Blinisht, gjendet varri i Monsinior Antonio Sharrës, misionarit italian që ka një rol të pasdiskutueshëm në ringjalljen e vlerave më të mira të zonës; si në fushën e kulturës e historisë, ashtu edhe në etnografi e artizanate.

ERNEST MARKU, shkrimtar

Zadrima, or as it was known in antiquity and in the early Middle Ages: Sapa, is an early settlement, as the Illyrian tumulus between the villages of Blinisht and Fishta testify. Sapa, Zapa or Capi, is an old town whose traces can be found in the ruins of the medieval Shat, above the present-day village of Nenshat. Various toponyms such as the Stone Bridge, the Old Bridge; or constructions such as the Church of Our Lady of Troshan, of St. Stefan in Blinisht, or of St. Mary on Vau i Dejes, are mainly of the 13th century. Well-known cities of ancient and medieval Zadrima were Shurdhah, Zhavorina, Danja, Sapa etc.

Zadrima wedding is another living proof of a centuries-old culture, elements of which form the basis of the old Shkodra wedding. Zadrima's villages are filled with 150-year-old towers, featuring architectural, iron and wood processing mastery, as well as evidence of the way of life of large Zadrima families. The tradition of making their clothes on local looms manufacturing is still preserved today, as is pottery. Cultivation of vine, olive, pomegranate, fig, invasive and other fruits; alongside ancient plants such as wheat and corn, or livestock breeding; are some of the things that stand out.

Gjergj Fishta, is the largest of a series of big names this region has come up with, which unfortunately today does not have much investment to perpetuate this legacy as a museum or memorial house. In Blinisht, there is the tomb of Monsignor Antonio Sharra, the Italian missionary who has an unquestionable role in reviving the region's best values; both in the field of culture and history, as well as in ethnography and crafts.

ERNEST MARKU, Writer

VESHJE E VAJZËS ZADRIMORE
ZADRIMA GIRL'S COSTUME

MODEL: ASIA KOKA

VESHJE E DJALIT ZADRIMOR
ZADRIMA BOY'S COSTUME

MODEL: SAMUEL GEGA

VESHJE E VAJZËS ZADRIMORE
ZADRIMA TEENAGER'S COSTUME

MODEL: DAJANA FILIPAJ

Duhet theksuar fakti se mbijetesa e veshjes zadrimore lidhet edhe me faktin që kjo ka qenë një veshje shumë e lehtë dhe praktike për t'u veshur çka ka ndikuar që kjo zonë të jetë një nga zonat ku ende mund të shohësh të ruajtur me kujdes këtë traditë edhe në përditshmëri, e jo vetëm në raste festash.

It should be emphasized that the survival of the dress is also related to the fact that this was a very easy and practical dress to wear which has made this area one of the areas where you can still see this tradition carefully preserved and the costume worn even on a normal day, not just on holidays and occasions.

VESHJE E DHËNDRRIT ZADRIMOR
ZADRIMA GROOM'S COSTUME

MODEL: FLORJAN LUFI

VESHJE E NUSES ZADRIMORE
ZADRIMA BRIDE'S COSTUME

MODEL: SUELA LUFI



VESHJE E BURRIT ZADRIMOR
ZADRIMA MAN'S COSTUME

MODEL: ANTON PRENDI

MODEL: VIOLETA PRENDI

VESHJE E GRUAS SË RE ZADRIMORE
ZADRIMA YOUNG WOMAN'S COSTUME

VESHJE E BURRIT ZADRIMOR
ZADRIMA MAN'S COSTUME

MODEL: GJOVALIN MARKU

VESHJE E GRUAS ZADRIMORE
ZADRIMA WOMAN'S COSTUME

MODEL: VITORE LUFI

KALLMETI

Treva e Kallmetit ndodhet në pjesën veri-perëndimore të Lezhës, e shtrirë rrëzë malit të Velës. “Kallmeti ka emër” do thoshtë At Gjergj Fishta pasi kjo trevë ka një histori të pasur patriotike si vend kuvendesh dhe personalitetesh të shquara të pushkës dhe penës. Por edhe histori religjoze si qëndër ipeshkvnore, me kisha të bukura qindra vjeçare por edhe shumë bij e bija klerike. Vetë natyra i ka dhënë ekskluzivitetin e varieteteve të rrushit dhe verës Kallmet por dhe të fasulës. Të gjitha këto i japin një identitet prej kallmetori në fushën e Zadrimës, rrezë maleve të Mirditës. Ajo që i jep bukurinë këtij oazi kulturor është veshja. Ku ka me bukur se veshja e gruas dhe nusës kallmetore, veshje e vjeter që dallon me krahinat përreth, nga forma, punimet dhe ngjyrat. Veshja kallmetore ndryshon në varësi të moshës. Tek nusja kallmetore paraqitej e gjithë krijimtaria, ku kishtë këmishën me anë lëkure, të prerë me 6 kina, e zbukuruar pranë qafës dhe mëngët e gjëra dhe të zbukuruara. Poshtë kemishës vishnin fanela pambuku të kuqe ose të verdhë. Sipër këmishës vishej gunza prej shajaku me 20 kina, e bardhë dhe ne fund me gajtana të zinj, pa mëngë dhe e gjatë deri në gju, shoqëruar me brezin e zi me zogj me ngjyra, licën, përparësen me dy shami, të gjitha plot ngjyra dhe zbukurime popullore. Ndërsa sipër gunzës vishej jelek shajaku, me gajtana të kuq dhe fije ari. Në qafë ndodhej një gjerdan sermi plot xhevahire, pare, hajmali, etj dhe në ballë kurora me stringla. Në kokë vihej një pashnik i verdhë dhe sipër saj duvaku i kuq ndërsa sipër gunzës e jelekut vishej dollama. Këpucët e kuqe dhe çorape të zbukuruar plot hijeshi.

Pas 5-6 vitesh nuset hiqnin të verdhat duke kaluar me më të zbardhura dhe pastaj të bardha. E gjithë veshja e kallmetores përgatitej nga vetë ato me vegë (tezgjah). Kjo veshje shtrihet në fshatrat Kallmet, Rraboshtë dhe Mërqi duke arritur deri në Manati.

Veshja e burrit kallmetor ka specifikat e veta por që nuk dallon shumë nga veshja e krahinave përreth pasi burrat duke qenë në lëvizje si në luftë, punë apo tregti, ishim gjithmonë me të integruar me tyre dhe blinin rroba në tregje të përbashkëta.

Evaristo Coli, studiues

The Kallmet area is located in the northwestern part of Lezha, lying at the foot of the Vela Mountain. “Kallmet has a good name” said Father Gjergj Fishta, as this area has a rich patriotic history as a place of prominent assemblies and personalities. But it has also an important religious history as a bishopric center, with beautiful churches hundreds of years old but also many clergy sons and daughters. Nature itself has given to this area the exclusivity of the grapes, olives and bean varieties, all named Kallmet. For these reasons, this area maintains a distinctive authenticity, overlooking the field of Zadrima at the feet of within the Mirdita Mountains.

The most distinctive and beautiful part of this area is the clothing. Where can you find a more beautiful costume than Kallmeti costumes of woman and the bride, the dress that differs from the surrounding provinces, in form, working and colors. The costumes vary with age. All the creativity was best presented to the beautifying the bride, with her leather-trimmed, 6-foot-long shirt adorned with a neckline and wide, ornate sleeves. Underneath the shirt were red or yellow cotton jerseys. Above the shirt she wore a felt cloak adorned with 20 laces, of white color and bottomed with black, sleeveless and knee-length, paired with a black band with colorful birds, the apron with two-handkerchiefs, all with colorful and popular ornaments. While above the cloak was worn a short cape, a scarf, a red vest with gold threads. At the neck was a necklace full of jewels, money, talisman, etc. and on the forehead crowns with strings. A yellow kerchief and a red duvet was over her head while a robe was worn over her vest to the waistcoat. All this accompanied by red shoes and socks adorned with elegance.

After 5-6 years the brides removed the yellow by turning to whitish and then white. All of the dressmaker’s clothing was made in the looms themselves. This costume extends to the villages of Kallmet, Rraboshte and Mërqi reaching as far as Manati.

The Kallmeti man’s dress has its own specifics but it is not much different from the dress of the surrounding provinces as the men being always on the move like in war, work or trade, were always more integrated with them and bought clothes in common markets.

Evaristo Coli, researcher

VESHJE KALLMETORE E VAJZËS
KALLMET GIRL'S COSTUME

MODEL: KETRIN NIKOLLI

VESHJE KALLMETORE E DJALIT
KALLMET BOY'S COSTUME

MODEL: GIVERS DEDGJONAJ

VESHJE E NUSES KALLMETORE
KALLMET BRIDE'S COSTUME

MODEL: DESARA GJINI

VESHJE E GRUAS KALLMETORE
KALLMET WOMAN'S COSTUME

MODEL: LEZE GJINI

VESHJE E BURRIT KALLMETOR
KALLMET MAN'S COSTUME

MODEL: LLESH PRENGA

SHEHRI (QYTETI)

Është e mirëkuptueshme që veshja tradicionale e qytetit të Lezhës ose Shehrit, lagjes së vjetër, është e influencuar më së shumti nga Shkodra si shkak i lëvizjeve dhe miqësive të shumta që e lidhnin me qytetin e vjetër. Doket e tradita, mënyra e jetesës e deri tek ushqimet është e mbartur nga nënat e nuset të cilat merreshin nga Shkodra.

Veshja e nuses mban edhe krenarinë edhe ngjyrën (ixhi) e cila ngjason me ngjyrën e perlave në të shndritur. Nusja vesh 2 palë barnavekë, një palë me një copë 12 metra të gjatë në brendësi, e cila vjen në pajën e nuses dhe do të përdoret si qefini i saj kur të vdesë dhe 12 metra janë pjesa e sipërme si copë satën i cili do të jetë qefini i bashkëshortit.

Ndërsa vitet kalojnë, edhe veshja e gruas nis të ndryshojë ngjyrë, me barnavekët të cilat me kalimin e viteve bëhen në ngjyra me të mbyllura (bezhe, kaf, gri), por duke ruajtur si karakteristikë sërish lulet, të cilat janë të reflektuar gjatë gjerësisë së barnavekëve mbuluar nga boçet ose çevret e kombinuara bukur.

Thonë që qeleshja e burrit ka pasur formë të rrumbullakët dhe me gjatësi jo më shumë se pëllëmba e burrit. Çakçirët kanë qënë në ngjyrë pana dhe kafe sipas rasteve, të veshura me këmisha të bardha të rrahura bukur në pjesën e mëngëve dhe me jakë prifti, siç quhej. Xhamadani ka qënë I bollshëm dhe me nji xhep për sahatin (qostekun) i punuar me qëndisje si pjesa fundore e çakçirëve.

EMA OSMANI, organizuese eventesh

It is well understood that the traditional dress of the city of Lezha or Shehri, the old neighborhood, is mostly influenced by Shkodra due to the many movements and friendships that linked it with the old city. The customs and traditions, the way of life and the food are brought by the mothers and the brides who came mainly from Shkodra.

The bride's dress bears both pride and the color (inji) that resembles the color of pearls in glitter. The bride wears 2 pairs of barnaveke (slack trousers), a 12-meter-long pair on the inside, which comes with the bride's dowel and will be used as her shroud when she dies, and the outer 12-meter-long satin piece that will be the spouse's shroud.

As the years go by, the woman's clothing begins to change color as well, with the barnaveke becoming more closed in color (beige, brown, gray) over the years, but still retaining the flowers, which are reflected in all the latitude covered by beautifully combined aprons or chevrons.

It is said that the man's hat was round in shape and no longer than the man's palm. The jackets were colored in brown and, as the case may be, dressed in beautiful white shirts, embroidered on the sleeves and having the priest's collar, as it was called. The doublet has been spacious and with an embroidered pocket for the watch.

EMA OSMANI, event organiser



VESHJA E VAJZËS ROME
ROMA GIRL'S COSTUME

MODEL: ALESIA SKURA

Fakti që, ndryshe nga shumë vende të tjera, në Shqipëri Romët nuk janë përndjekur, ka ndikuar shumë në bashkëveprimin e tyre të rritur me kulturën dhe traditat lokale, dhe sot shumë nga të rinjtë romë identifikohen me traditat lokale shqiptare, edhe kjo duke ndikuar në mënyrën e përpunimit të kostumeve tradicionale.

The fact that, unlike in many other countries, in Albania the Roma have not been persecuted, has influenced very much in their grown interaction with the local culture and traditions, and today many of the young Roma identify with the local Albanian traditions, this also influencing the way of considering traditional costumes.

VESHJA E DJALIT ROM
ROMA BOY'S COSTUME

MODEL: ENIS HUTI





VESHJA QYTETARE E VAJZËS
TOWN GIRL'S COSTUME

MODEL: SONIA KOKA



VESHJA QYTETARE E BURRIT
TOWN GROOM'S COSTUME

MODEL: EDMIR BEGANI



Veshja e nuses mban edhe krenarinë edhe ngjyrën (ixhi) e cila ngjason me ngjyrën e perlave në të shndritur. Nusja vesh 2 palë barnavekë, një palë me një copë 12 metra të gjatë në brendësi, e cila vjen në pajën e nuses dhe do të përdoret si qefini i saj kur të vdesë dhe 12 metra janë pjesa e sipërme si copë satën i cili do të jetë qefini i bashkëshortit.

The bride's dress bears both pride and the color (inji) that resembles the color of pearls in glitter. The bride wears 2 pairs of barnaveke (slack trousers), a 12-meter-long pair on the inside, which comes with the bride's dowel and will be used as her shroud when she dies, and the outer 12-meter-long satin piece that will be the spouse's shroud.

VESHJE E NUSES QYTETARE
LEZHA TOWN BRIDE'S COSTUME

MODEL: EMA OSMANI

VESHJE E GRUAS QYTETARE
SHEHËR WOMAN'S COSTUME

MODEL: NAFIJE TYMI

VESHJE BURRI QYTETAR
SHEHËR MAN'S COSTUME

MODEL: HAJDAR HYSA



Kostumi në këtë faqe është kostumi tradicional qytetar. Kostumi i burrit, është shumë i vjetër, me qakqirat dhë këmishën 150 vjeçare. Pëlhura e këmishës është e punuar ne tezgjah dhe e qëndisur me fije mëndafshi. Qëndismat në kraharor dhe në dorëzat e këmishës janë të punuara me dorë nga mjeshtrat e vjetër shkodranë. Qakqirat janë të punuara me dorë, të qendisura me gajtana të punauar në mënyrë artizanale. Brezi është punuar me fije leshi në tezgjah.

This costume is the traditional old city's costume. The man's suit is very old, with his 150-year-old shirt and felt trousers. The shirt fabric is handmade and embroidered with silk thread. The embroideries on the chest and the wrists on the shirt are handmade by the old craftsmen of Shkodra. The trousers are handmade, embroidered with handmade laces. The belt is made of wool yarn on the traditional local loom.

MIRDITA

Mirdita është një nga zonat etnografike të Shqipërisë me veçoritë e saj etnokulturore të spikatura, që kanë të bëjnë me mënyrën e jetesës, vetëqeverisjen krahinore, doket dhe ritualet në dasma dhe ditë të shënuara.

Një nga këto veçori dalluese është dhe veshja tipoligjike mirditase, sidomos ajo e grave dhe vajzave, që, për shkak të vlerave autentike burimore dhe paraqitjes së hijshme, është ekspozuar dhe në metropole të kulturës europiane etj.

Kjo veshje është përdorur gjërësisht nga ansambli "Mirdita" (Rrëshen) në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës dhe pjesërisht nga ansambli folkorik "Çiftelia" i Lezhës, ansambli folklorik i Pukës etj. Po ashtu kjo veshje është fiksuar në kartolina dhe është pikturuar nga piktorë të ndryshëm shqiptarë e të huaj. Për shumëkënd mbahet si veshja më e bukur shqiptare.

Studiuesi dhe udhëpërshkruesi korçar i viteve '30 të shekullit të kaluar Stavri Frashëri, e përshkruan me imtësi veshjen e gruas mirditore, duke e cilësuar si shumë të bukur: Shaminë që mbajnë në kokë gratë e martuara e shkojnë mbi vesh, kurse vajzat e lidhin nën mjekër, në mes ngjeshin qemerin e kuq dhe një stravecë të kuqe, tërë xhufka të lëshuara, të cilën vajzat e kanë me ngjyrë të zezë. Në brez mbërthejnë një "fille drynit", një këmishë e bardhë dhe e gjatë mbulon një pjesë t'antarisë, kurse mbi opingat ajo ka formën e një balone të fryrë. Përmbi këmishë hedhin xhupin prej leshi të bardhë, të gjatë dhe me dekorime artistike mbi supe dhe prapa. Xhurdia e zezë i ngjan asaj të burrave dhe vishet mbi xhupin. Krahanorin ua zbukurojnë paret e qafës, të cilat mund të jenë pesë korona bashkë të ngjitura mbi një qostek prej sermi. Ndonjë qostek tjetër prej sermi me një kryq është gjithashtu send që zbukuron qafën, gishtërinjtë e mbuluar me tri-katër unaza t'argjenda, bukuria e të cilëve varet nga shijet e gruas që i mban. Në veshë iu varen vëthë prej sermi në forma të ndryshme. Këmbët i zbukurojnë me opinga prej lëkure dhe me çorape të bukura dhe mbi to mbathin një palë çorape të shkurtëra qendisur me tel, të cilat i quajnë shputa... (S. Frashëri, "Përmes Mirditës në dimër", Korçë 1930.)

Etnografja franceze Zhaklin Benezech, teksa eksploron Mirditën e 1939-ës, ndalet posaçërisht te kostumi i gruas mirditore, për të cilin shkruan: "…Vështirë të imagjinoja kostum më hijerëndë dhe njëkohësisht më të jashtëzakonshëm nga bukuria dhe me një prerje aq mjeshtërore…"

Veshja tradicionale e krahinës së Mirditës përdoret dhe sot nga banorët, sidomos në dasma, nga grupet e folkut në rajonet ku janë vendosur mirditorët e shpërngulur pas 1990-s, si Lezhë, Kurbin, rrethinat e Tiranës, Durrësit etj. Kjo veshje është mjaft e pëlqyer dhe nga valltarët e rinj, që përformojnë me të që në kopsht e bangat e shkollës. Një grup grash zejtare në Rrëshen, Rubik etj. e kanë përtërirë traditën e qepjes së petkave krahinore me stilizimet e vjetra të larmishme.

NDUE DEDAJ, shkrimtar

Mirdita is one of the ethnographic areas of Albania with its prominent ethnocultural features related to lifestyle, provincial self-government, docks and rituals at weddings and marked days.
One of these distinctive features is the typical Mirdita typological costume, especially the one of women and girls, which, due to its authentic sourced values and graceful appearance, has also been exposed in European cultural metropolises.
This costume has been widely used by the ensemble "Mirdita" (Rrëshen) at the National Folk Festival of Gjirokastra and partly by the folk ensemble "Ciftelia" of Lezha, folk ensemble of Puka etc. Also this dress is fixed on postcards and painted by various Albanian and foreign painters. For many it is regarded as the most beautiful Albanian dress.
Stavri Frasheri, a Korça scholar and traveler of the 1930s, elaborately describes the Mirdita woman's dress, describing it as very beautiful: The headscarf that married women wear is kept over their ears, while the girls tie it under the chin, in the waist they put the red belt and a red apron, with all the tassels falling, which the girls wear in black. In the belt is fastened a "lock line", a white and long shirt covers part of the tank, while over the sandals it is shaped like a blown balloon. Above the shirt lay the white, long woolen sweatshirt with artistic decoration on the shoulders and back. The black jersey resembles that of men and is worn over the sweatshirt. Their chests are adorned with necklaces, which can be five kings' coins welded together on a silver hook. Another silver chain with a cross is also an item that adorns the neck, the fingers are covered with three or four rings, whose beauty depends on the tastes of the woman holding it. Ears of various kinds hung on their ears. Their feet are adorned with leather sandals and fine socks and on them are worn a pair of short socks, embroidered with golden wire, which they call "shputa" ... (S. Frashëri, "Through Mirdita in Winter", Korça 1930.)
French ethnographer Jacqueline Benezech, while exploring Mirdita of 1939, specifically focuses on the Mirdita woman's costume, of which she writes: "... I could hardly imagine the costume more graceful and at the same time extraordinary by beauty and with such a masterful cut ..."
Traditional clothing of the province of Mirdita is still used today by residents, especially at weddings, by folk groups in areas where displaced post-1990 migrants have settled, such as Lezha, Kurbin, the suburbs of Tirana, Durres, etc. This dress is well liked by the young dancers, who wear it during their performances since kindergarten. A group of women craftsmen in Rrëshen, Rubik etc. have renewed the tradition of sewing the provincial garments with the varied old stylizations.
In the district of Lezha, the Mirdita costume, can be found alongside that of Zadrima, Kallmet, Kurbin, Malesia e Madhe, etc.
NDUE DEDAJ, writer

VESHJE MIRDITORE E VAJZËS
MIRDITA GIRL'S COSTUME

MODEL: AMBLA NDOKA

VESHJE MIRDITORE E DJALIT

MIRDITA BOY'S COSTUME

MODEL: ARLIND MARKU; OLSI MARKU

VESHJE MIRDITORE E VAJZËS
MIRDITA GIRL'S COSTUME

MODEL: VASILIKA LASKA

VESHJE MIRDITORE E NUSES
MIRDITA BRIDE'S COSTUME

MODEL: ROVENA ZEKAJ

VESHJE MIRDITORE E DHËNDRRIT
MIRDITA GROOM'S COSTUME

MODEL: ARMAND ZEKAJ

VESHJE MIRDITORE E GRUAS
MIRDITA WOMAN'S COSTUME

MODEL: TEREZE GEGA

VESHJE MIRDITORE E BURRIT
MIRDITA MAN'S COSTUME

MODEL: FRAN PREÇI

MALËSIA E MADHE

Në trashëgiminë materiale shqiptare, e para ishte xhubleta!. Ajo është një element i rëndësishëm i kësaj kulture që trashëgohet nga shekujt. Studiuesit kanë arritur në përfundim se, tipi i kostumit me xhubletë është përdorur herët në Ballkan e në brigjet e Mesdheut dhe se ka jetuar për shekuj në qytetërimin ilir. Arkeologë e etnografë të njohur janë të mendimit se xhubleta shqiptare ruan shumë tipare të ngjashme me një veshje të vjetër mesdhetare. Në ikonografinë etruske, Z. Majani (Z. Mayani) veçon figurën e një valltareje të shkathët etruske të cilën e krahason, sa i takon veshjes, me xhubletën si veshje kombëtare shqiptare të ruajtur sot në Malësinë e Madhe. Ajo ka strukturë të pasur artistike. Forma e papërsëritshme, ngjyrat, ornamentet dhe stili i zbukuruar i japin asaj karakteristika dalluese nga veshjet e tjera tradicionale për gra. "Historitë e popujve të tjerë gjenden përgjithësisht të gdhendur në gur, ndërsa historia jonë është e qëndisur në xhubletë", shprehet një studjuese shqiptare e etnografisë. Xhubleta e malësores shqiptare vjen nga 4000 vjet histori. Bota nuk ka një veshje të dytë si xhubleta.

Kjo veshje i përshtatet karakterit fisnik të malësoreve dhe natyrës krenare të maleve të larta, duke i bërë ato më solemne në këtë veshje, e cila të tërheq me madhështinë e sajë. Një studjuese e ka quajtur xhubletën "Fund të krekosur e të valëzuar.... Sa hijerëndë, burrërore, stoike dhe e fortë si malet, të duket gruaja malësore nën këtë veshje."

Në tipologjinë e veshjeve shqiptare, veshja me xhubletë e gruas së Malësisë së Madhe përbën një nga monumentet më të çmuara të trashëgimise kulturore shqiptare. Kjo veshje madhështore, ruan përveç bukurisë edhe një linjë trashëgimie të simboleve të moçme ilire, të cilat u konservuan deri ditët e sotme prej shqiptarëve.

Dr. GJOVALIN GJELOSHI, studiues

In the Albanian material heritage, the first one was the xhubleta!. It is an important element of this culture that has been inherited for centuries. Researchers have come to the conclusion that the type of costume with xhubleta was used early in the Balkans and on the Mediterranean coast and that it has lived for centuries within the Illyrian civilization. Well-known archaeologists and ethnographers are of the opinion that the Albanian xhubleta retains many features similar to an old Mediterranean dress. In Etruscan iconography, Mr. Mayani (Mr. Mayani) highlights the figure of a skilled Etruscan dancer whom she compares, in terms of dress, to xhubleta, the same Albanian national costume which is preserved today in the Highlands of Malsia. It has a rich artistic structure. The unmistakable shape, colors, ornaments and style give it distinctive features from other traditional women's dresses. "The histories of other peoples are generally carved in stone, while our history is embroidered in the xhubleta", says an Albanian ethnography researcher. The Albanian Malsia Xhubleta comes from 4000 years of history. The world does not have a second costume whith such history.

This dress fits the noble character of the Highlanders and the proud nature of the high mountains, making them more solemn in this dress, which captivates you with its magnificence. One researcher has called the xhubleta a "puffy, corrugated bottom .... As graceful, brave, stoic and strong as the mountains, the malsia's woman looks like under this dress. "

In the typology of Albanian clothing, the Malsia's Woman's cpstume with xhubleta constitutes one of the most precious monuments of Albanian cultural heritage. This magnificent costume preserves in addition to beauty a line of heritage of the ancient Illyrian symbols, which have been preserved to this day by Albanians.

Dr. GJOVALIN GJELOSHI, researcher

Vajza deri në moshën 12 vjeçe vishte një lloj fustani kryesisht të leshtë, të endur në vekë. Pas moshës 12 vjeçe vishte xhubletën e vajzënisë, e cila në dallim me xhubletën tradicionale që njohim ne, ishte e bardhë e alternuar me shirita të zi, pothuaj në mënyrë të barabartë. Postava ishtë në ngjyrë të bardhë me shirita të zi të vendosur në mënyrë në mënyrë vertikale. Krahcat e zeza e nganjëherë edhe të bardha dhe këmisha e bardhë. Në kokë vajza vendoste shami të bardhë dhe flokët i mbante të shtrirë, të pa rregullura me onde. Çorapet nga shputa deri në mesin e kërcirit ishin me ngjyrë të zezë dhe sipër të bardhë ose të alternuar bardh e zi. Edhe lidhësja e çorapeve ishte me dy fije spiku: një e bardhë dhe tjetra e zezë. Këtë veshje e mbante vajza deri kur martohej. Në fejesë kësaj veshje i shtonte edhe një shirit të zi të lidhur në ballë poshtë shamisë.

The girl up to the age of 12 was wearing a predominantly woolly dress, made on the loom. After the age of 12 she wore a girl's "xhublete", which, unlike the traditional xhublete we know, was alternately white with black stripes, almost equally. The "postava"- apron was white in black with vertical strips of black. The sleeves were black with white sometimes, and the shirt was white. The girl was wearing white kerchiefs on her head and her hair was stretched out, not wavy. The socks from the toe to the midsole were black and over white or alternately white and black. Even the sock connector had two spiky threads: one white and the other black. The girl wore this dress until she got married. At the engagement, this dress was also added a black strap tied to the forehead under the scarf.

VESHJE MALËSORE E VAJZËS
MALSIA GIRL'S COSTUME

MODEL: MELISA FIGURI

VESHJE MALËSORE E DAJALIT
MALSIA BOY'S COSTUME

MODEL: ERMANDO KODËR-VELAKAJ

VESHJE MALËSORE E VAJZËS
MALSIA TEENAGER'S COSTUME

MODEL: ORNELA MARKU

VESHJE MALËSORE ME XHUBLETE
GRAND MALSIA'S COSTUME

Veshja tradicionale malësore me çakshir, xhamadan e xhubletë, përfaqësuese e veshjes së Malësisë së Madhe

Traditional Malsia costume, with çakshir, xhamadan e xhubletë, representing Grand Malsia

Në fotografi/ in these photos, Luigj dhe Veronika Dedvukaj
Fotograf/ Photo by: Vinko Prënkoçaj,

Bardhaj-Hot, 2015



VESHJE MALËSORE E GRUAS
MALSIA WOMAN'S COSTUME

MODEL: NATALINA KOLA

VESHJE MALËSORE E BURRIT
GRAND MALSIA MAN'S COSTUME

MODEL: PAL DEDGJONAJ

KURBINI (PLLANA)

E gjendur në krahun e djathtë të lumit Mat, sapo lumi zbret në fushë, është vendi ideal për vendbanim dhe për jetesë. Në krye të Pllanës gjendet Kisha e rëndësishme e Shën Barbarës (Sh'Barbulla), që së bashku me kishat e tjera shpërndarë për gjatë luginës poshtë dëshmojnë për një zonë të banuar me kohë dhe që ka patur prosperitet. Këtë mirëqënie e dëshmojnë edhe legjendat e pafund që e shoqërojnë, së bashku me gjurmët e qytetërimeve të lashta që gjenden ngado në këtë zonë.
Edhe kostumi popullor I zonës së Pllanës është një dëshmi e autenticitetit dhe veçantisë së kësaj zone, si një oaz në mes të Mirditës, Krujës, Lezhës e Matit. Më e çelur se e Mirditës, dhe më me shumë elemente se e Krujës, veshja e Pllanës dëshmon një bukuri shpirtërore të kësaj treve, si dhe të gjendurit e qytezës pranë një pazari të rëndëishëm ku janë shkëmbyer mallra dhe tradita.
Por të qënit oaz, ka krijaur edhe problemet e veta, pasi sot, është shumë e vështirë të gjenden costume tipike të Pllanës. Ndërkohë që gratë e Pllanës kanë ndërruar jetë, ato janë përcjellë së bashku me kostumet e tyre më të bukura, duke e vështirësuar jashtëzakonisht punën për gjetjen e këtyre kostumeve tashmë në përditshmëri.
Në ansamblet folklorike të Lezhes binte në sy lehtësisht kostumi folklorik I Pllanes, me ngjyrat e rruazave të bardha e të verdha, dhe me qëndismat e mrekullueshme të grykëses dhe të këmishave fantastike. Ndoshta, e veçanta e kostumit të Pllanes qëndronte edhe me faktin që kishte dy lloj kostume grash: kostumin e gruas myslimane me rruaza, dhe kostumin e gruas katolike me qëndisma. Ishin kohë të vështira, dhe ky dallim nuk duhej permendur. Sot, pas shumë vitesh qe kur nuset pushuan së sjelli në pajë kostumet e tyre shekullore të nuserisë, ato gra të fundit që i kishin pergatitur me aq shumë kujdes, ose u varrosën me ato kostume, ose i harruan kur lëvizën per në zona të tjera, pasi harresa është me e lehtë kur je larg shtëpisë.

Located on the right side of the Mat River, once the river descends into the plain, it is the ideal place for habitation and living. At the top of the hill in Pllana is the important Church of St. Barbara (Sh'Barbulla), which, along with other churches scattered down the valley, testify to a early inhabited and prosperous area. The endless legends that accompany it, along with the traces of ancient civilizations found throughout the area, bear witness to this well-being.
Even the popular costume of the Pllana area is a testament to the authenticity and uniqueness of this area, as an oasis between Mirdita, Kruja, Lezha and Mati. Lighter than Mirdita's, and more elements than Kruja's, Pllana's dress attests to the spiritual beauty of the area, as well as the town's close proximity to an important bazaar where goods and traditions have been exchanged.
But being an oasis has also created its own problems, as today it is very difficult to find typical Pllana costumes. While the women of Plana have passed away, they have been accompanied along with their finest costumes, making it extremely difficult to find these costumes nowadays.
In the folk ensembles of Lezha, the folk costume of Plane was easily noticeable, with the colors of white and yellow beads, and the gorgeous embroideries of the gorge and the fantastic shirts.
Perhaps, the particularity of Pllanes' suit was also due to the fact that there were two types of women's suits: the Muslim woman's costume, and the Catholic woman's embroidered costume. They were difficult times, and this distinction was not to be mentioned. Today, after many years since brides stopped bringing their centuries-old bridesmaid costumes with their dowry, those last women who had prepared them so carefully, were either buried in those suits, or forgotten when moving to other areas , since forgetting is easier when you're away from home.



Nëse në të gjitha kostumet e tjera që kemi studiuar, napoleonat ishin elemente të bizhuve zbukuruese ose të qafës, ose të ballit të nuses, në kostumin e Kurbinit, këto napoleona janë të qëndisura si pjesë e jelekut që vesh nusja, në ato që quhen “bishtaleca” e që varen në dy anët e shpinës së nuses.

If in all the other costumes we studied, napoleons (the golden coins) were elements of ornamental for the neck or bride’s front, in Kurbin's suit, these napoleons are embroidered as part of the vest that the bride wears, in what are called "bishtalecat (braids)” that hang on both sides of the bride's back.

VESHJE E NUSES SË PLLANËS
PLLANA BRIDE’S COSTUME

MODEL: XHOVANA ABEDINI





VESHJE E DHËNDRRIT KURBINAS
KURBIN GROOM'S COSTUME

MODEL: IBRAHIM LIKA









VESHJE E NUSES KURBINASE
KURBIN BRIDE'S COSTUME

MODEL: LEZE RRIKA

VESHJE E ZHEJËS
ZHEJA WOMAN'S COSTUME

MODEL: ANGJELINA GJEGJI



VESHJE E GRUAS
KURBIN
WOMAN'S COSTUME

MODEL: MIRELA LIKA

VESHJE E BURRIT KURBINAS
KURBIN MAN'S COSTUME

MODEL: KURT LIKA

ETNO LEZHA

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë
Lezha, Etno
History in clothing: photo album = Historia në kostume:
album fotografik / Etno Lezha ;
fotot Olsi Tetaj; konsulente etnografike Tereze Gega.
– Tiranë : Geer, 2019
98f.: me foto; 25.0x 30.0 cm.
ISBN 978-9928-07-656-4
1. Etnologjia 2. Kostume 3. Albume
4. Zadrimë 5. Shqipëri
391(496.526-3) (084.12)